

# "BREGDETI" (RIVIERA) ASSOCIATION

Defending Property, Pursuing Justice

P.O. Box 258 • Tirana, ALBANIA

Phone: +355 69 34 55 112 • E-mail: [shoqatabregdeti@yahoo.com](mailto:shoqatabregdeti@yahoo.com), Web:  
[www.defendingproperty.com](http://www.defendingproperty.com)

---

Mr. Lamberto Zannier, Secretary General  
Organization for Security and Cooperation in Europe  
Wallnerstrasse 6  
1010 Vienna, Austria

Mr. Eugen Wollfarth, Head  
OSCE Presence in Albania  
Sheshi "Italia"  
Sheraton Hotel, 1st Floor  
Tirana, Albania

Herman Van Rompuy, President of the European Council  
European Council  
Rue de la Loi 175  
B-1048 Brussels, Belgium

Mr. Ettore Sequi, Head  
EU Delegation in Albania  
ABA Business Center, Rr. Papa Gjon Pali II, 17th floor  
Tirana, Albania

Ambasadorëve të Trupit Diplomatik të Akredituar në Shqipëri

Tiranë, me 18.12.2012

Shkëlqesia juaj,

Në emër të pronarëve të ligjshëm të zonës turistike Vlorë-Sarandë të shpronësuar me dhunë nga regjimi komunist, në vijim të disa kërkesave drejtuar përfaqësisë së OSBE në Tiranë, ju shkruajmë në lidhje me **projektin prej 1.6 milion Euro të drejtuar prej përfaqësisë së OSBE-se në Shqipëri për regjistrimin e pronave në zonat turistike te bregdetit.**

Autoritetet shtetërore shqiptare nuk po e zbatojnë nenin 181 të Kushtetutës i cili parashikon zgjidhjen e problemit të kthimit të pronave të shpronësuar nga regjimi komunist brenda vitit 2001 (!) konform të drejtës themelore të pronës private e cila garantohet nga neni 41 i Kushtetutës. Më keq akoma, strategjia e re ndërsektoriale e Qeverisë për pronat 2012-2020 parashikon një shtyrje tjetër të afatit të kthimit të pronave në vitin 2020, ndërkohë që afati për përfundimin e "legalizimeve" fiksohet në fund të 2013. Për ne strategjia e Qeverisë është e qartë: injorim i kthimit fizik, mospërfillje e afateve kohore për anulimin e

akteve që bien ndesh me nenin 181 të Kushtetutës, shtyrje dhe pengim i kthimit të pronës. Kjo strategji ka për qëllim "legalizimin" e vjedhjeve dhe abuzimeve të pronave të pronarëve të ligjshëm nga elitat politike e ekonomike në pushtet. Kjo strategji i shërben objektivit final të qeverisë dhe politikës - konsolidimi i pushtetit ekonomik të elitave të regjimit komunist të cilat vazhdojnë të mbajnë në duart e tyre pushtetin ekonomik e politik dhe të servirin një farsë alternance mes forcave gjoja të djathta dhe forcave gjoja të majta. Pronarëve të ligjshëm, të shpronësuar e të persekutuar nga regjimi komunist, të nëpërkëmbur nga autoritetet gjatë këtyre 20 viteve "demokraci", iu mbetet vetëm një shpresë: presioni ndërkombëtar mbi politikanët shqiptarë për të zbatuar parimet themelore të një shteti demokratik.

Mos respektimi i të drejtave të pronësisë të pronarëve legjitime shoqërohet me një anarki të qëllimshme në administrimin e titujve të pronësisë dhe ka pasur për pasojë një numër të frikshëm vrasjesh për prona (mbi 6.000), një korrupsion të paskrupullt, pasiguri juridike e sociale, etj. Siti ne internet i shoqatave "Pronësi me Drejtësi" dhe "Bregdeti", [www.defendingproperty.com](http://www.defendingproperty.com), jep një përmbledhje të situatës, ndër të tjera të moszbatimit të vendimeve gjyqësore, perfshi edhe vendimet e Gjykatës së Strasburgut (shihni dokumente/ jurisprudence/vendimi unifikues i Kolegjeve të Bashkuara, letrat, artikujt, videot, etj).

Në kushtet aktuale, kur të dy krahët e politikës synojnë të "legalizojnë" e të konsolidojnë përfitimet e paligjshme të pasurive të realizuara, duke qenë në pushtet, ne mirëpresim e mbështesim çdo hap konstruktiv të ndërmarrë nga organizatat ndërkombëtare drejt zgjidhjes së këtij problemi. Në këtë kontekst, në lidhje me projektin e përfaqësisë së OSBE-se në Shqipëri për regjistrimin e pronave në bregdet, projekt që prek drejtpërdrejt pronat e zonës turistike Vlorë-Sarandë ku abuzimet me pronat janë shumë të dukshme, fillimisht konstatojmë se shoqatat tona nuk janë ftuar të marrin pjesë në disa mbledhje mbi këtë temë, si për shembull në mbledhjen e organizuar në Himarë me 9 nëndor 2012. Ne, si palë e interesuar direkt nga ky projekt, si përfaqësues të interesave të pronarëve të ligjshëm, **ju kërkohet të ftoni sistematikisht shoqatat "Pronësi me Drejtësi" dhe "Bregdeti" në çdo diskutim të këtij problemi.**

Së dyti ju informojmë se ne nuk disponojmë asnjë informacion mbi zgjidhjen e kësaj zone pilot që përfshin ky projekt i OSBE-se për rastet kur për të njejtën pronë ka disa pretendues, rast ky fatkeqesisht i shpeshtë. **Ju lutemi të na informoni si është parashikuar, në kuadër të këtij projekti, zgjidhja e rasteve kur për të njejtën pronë ka disa pretendues.** Do të ishte shumë e mirëpritur që ky informacion të bëhej publik. Ne jemi ankuar për një menaxhim të keq të drejtës së pronësisë. Rikujtojmë se ne kemi vënë në dijeni grupin e punës së OSBE-se, përpara se të fillonte zbatimi i projektit, se ky është një fenomen i mirënjohur dhe kemi theksuar se fondet e këtij projekti do të kenë vlera negative nëse nuk do të bëhet zgjidhja duke propozuar një projektligj që të përputhet me nenin 181 të Kushtetutës. Në një kohë të mëvonshme, ne kemi dorëzuar në zyrën e OSBE-se dhe BE-se projektligjin në shqip dhe anglisht. **Ky projektligj i hartuar nga specialistët tanë dhe juristët të huaj mendojmë se i zgjidh problemet e pronës** në përputhje me nenin 181 të Kushtetutës, me kërkesat e KE-se të datës 5 Dhjetor 2012 dhe me kërkesat e vendimit pilot të Gjykatës së Strasburgut dt. 31.07.2012, për zbatimin e të drejtave të pronësisë. **Ju ftojmë të prononcoheni publikisht për këtë projektligj lidhur me përputhjen e tij me Kushtetutën në fuqi nenin 181 dhe Konventën Europiane të të Drejtave të Njeriut.**

Ju informojmë se gjatë muajit Nëntor 2012, ka pasur konflikte të shumta se cila palë duhet ti vjeli prodhimet e ullinjve, ata që kanë marrë ullinjtë sipas ndarjes për frymë të bëra nga komisionet e ndarjes së pronës pas vitit 1994, dhe që veç dokumentit të komisionit nuk i kanë të regjistruara as në ZRPP, apo pala e pronarëve historikë që i disponojnë ato ullinj nga gjyshërit e tyre por që u shpronësuan pas vitit 1945 me ardhjen në fuqi të pushtetit komunist. Ne mendojmë se është në të mirën e të gjithë paleve që secili të gëzojë pronën e tij të trashëguar dhe të shpronësuarit të kompensohen vetëm për rastet kur ajo pronë është tjetërsuar ose shfrytëzohet për nevojat publike. Familjet e zonave veriore dhe ne 75% të Shqipërisë

kanë marrë në posedim pronat e trashëguara sipas kufijve të vjetër dhe kjo nuk ka shaktuar asnjë problem, ndërsa në zonat turistike dhe qytetet kryesore politikanët insistojnë të zbatohet një standard tjetër.

Dëshirojmë të besojmë se OSBE-ja, duke respektuar Kushtetutën e Shqipërisë dhe të drejtën themelore njërëzore të pronësisë private, do të njohë dhe konfirmojë, në kuadrin e këtij projekti, të drejtën e pronarëve të ligjshëm, titujt e të cilëve bazohen në regjistrat shtetërorë të para-kolektivizimit komunist. Këto tituj, dokumente me efekt konstituiv të së drejtës së pronësisë, gjenden sot në Kadastrat dhe në Arkivat e Shtetit. Duke qenë se njohja e këtyre titujve ka rëndësi jetike për respektimin e të drejtës themelore të pronësisë, **ju ftojmë të prononcoheni publikisht për këtë zgjidhje.**

Ne kemi bindjen se vetëm këmbëngulja dhe presioni, ndërkombëtar në përgjithësi dhe juaji në kuadrin e këtij projekti, që Shteti shqiptar të realizojë kthimin e pronës tek pronari i ligjshëm, konform Kushtetutës, do të bëjë të mundur zgjidhjen përfundimtare dhe të qëndrueshme të këtij problemi dhe do t'i hapë rrugën investimeve serioze dhe zhvillimit ekonomik të mirëfilltë. Cdo "zgjidhje alternative" e dëmton seriozisht kredibilitetin e institucioneve ndërkombëtare, në Shqipëri dhe përtej. Kërkesat tona mbështeten jo vetëm në Kushtetutë por edhe në jurisprudencën e gjykatave shqiptare dhe të Gjykatës së Strasburgut. Për një interpretim përfundimtar të kthimit të pronave pronarëve të ligjshëm të shpronësuar gjatë komunizmit ju ftojmë ti referoheni vendimit të Kolegjeve të Bashkuara të marsit 2002 dhe vendimeve të Gjykatës së Strasburgut, veçanërisht Driza k. Shqipërisë dhe Puto etj. k. Shqipërisë. Këto dokumente i gjeni në sitin tone (<http://defendingproperty.com/shqip/court-decisions/>). Në vendimin e saj të korrikut 2012, Gjykata e Strasburgut i kërkon Shqipërisë të zgjidhë brenda 18 muajsh (Dhjetor 2013) problemin e kthim/kompensimit. Gjykata e Strasburgut insiston se kompensimi financiar, ashtu siç është aplikuar aktualisht, nuk zgjidh por e rëndon problemin.

Qeveria aktuale shqiptare, përfaqësuese e denjë e të gjithë politikave që janë aplikuar në këtë fushë në Shqipëri këto 20 vitet e fundit, nuk dëshiron ta zgjidhë këtë çështje dhe problemin e kthimit e transformon në çështje kompensimi. Sigurisht shuma e kompensimit është e papërballueshme nga taksapaguesit shqiptare. Kështu bëhet e pashmangshme që kriza e pronës të shkaktojë kriza të tjera. Ne besojmë se taksapaguesi nuk ka pse të paguajë për t'i lejuar abuzuesve të përvetësojnë pronat e pronarëve të ligjshëm.

**Kompensimi dhe legalizimi nuk mund të bëhen pa përfunduar më parë kthimi fizik.** Shteti në kohën e vendosjes së sistemit komunist, ka qenë dhe mbetet pronar i ligjshëm i 52% të pronave të patundshme: rrjedhimisht ka mjaft fonde pronash për çdo lloj programi social në favor të personave në nevojë strehimi. Pronat e konfiskuara nga regjimi komunist duhet të kthehen tek i zoti, tani ! Kjo është zgjidhja e kërkuar nga neni 181 i Kushtetutës, kjo është zgjidhja që respekton të drejtat e të gjitha palëve. Për këtë duhet presion politik ndaj qeverisë shqiptare! Ju lutemi t'i dilni në mbrojtje respektimit të të drejtës së pronësisë në Shqipëri, politikisht dhe në kuadrin e këtij programi konkret që drejton institucioni juaj. Në pritje të përgjigjes për çështjet e nënvizuara më sipër, mbetemi në dispozicion për çdo lloj informacioni që mund t'ju nevojitet.

Me respekt,

Dr. Niko Nesturi, Kryetar  
Shoqatës "Bregdeti"